



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Studim i Veprës Letrare

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri : Viti II , Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor - *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Vepra e analizuar do të jetë romani “Agostini” i shkrimtarit Alberto Moravia, i cili konsiderohet si një roman i shkurtër ose si një novelë e gjatë dhe është një nga veprat më të mirënjohura si në rrafshin kombëtar letrar italian, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Gjatë këtij moduli synohet që studentit t’i mësohet se si të përvetësojë strategjitë kryesore të të lexuarit të një vepre letrare, të njohë fakte kulturore rreth Italisë, të zhvillojë strategji të thelluara në lidhje me studimin e një vepre letrare, e cilësdo gjini qoftë ajo. Ai gjithashtu duhet të njohë kontekstin letrar në të cilin ka lindur vepra që po analizohet, të njohë në thellësi veprimtarinë letrare të autorit, të analizojë elementët artistikë që e përbëjnë veprën etj.

Objektivat specifike lëndore:

1.Studenti të jetë i pajisur me skemën e përgjithshme të të interpretuarit të një vepre letrare, të njohë në thellësi funksionimin e kritikës letrare dhe rolin e saj në interpretimin e një vepre letrare, të njohë në kontekst veprën që merret në analizë, autorit, karakteristikave e shkrimtarëve të periudhës së cilës i përket autori, instrumentet e kritikës letrare dhe të jetë i aftë të nxjerrë deduksionet e duhura në fund të analizës.